



Trajneri i Lacit Stavri Nica pergezoi skuadren e tij per nje loje te forte e te bukur duke shprehur kenaqesine se ne cfare pozicioni ndodhet skuadra e tij, por ne te njejeten kohe kerkon nga djemte e tij qe te qendrojne me kembe ne toke e te mos behen euforik. "

Ishte një sfidë të cilën e kishim përgatitur me qetësi, pavarësisht se vinim pas një humbje dramatizuese në kampionat. Djemtë e interpretuan më së miri lojën dhe e zgjidhën atë që në pjesën e parë. Një lojë për tu duartrokatur, shtu këtu edhe dy golat mjaft të bukur të kapitenit tonë, ku rrallë herë i shohim në kampionat. E mbyllëm vitin kalendarik në mënyrën më të mirë të mundshme. Një fitore që falë golavarazhit na ngjiti në vëndin e tretë. Nuk mund të mohoj që mundësitë ishin për ta thelluar edhe më tepër rezultatin, por të rëndësishme janë pikët. Dominuam në ccdo cep të fushës dhe kjo ka rëndësi për ne. Sigurisht që nuk duhet të kënaqemi me aq pasi mundësitë jona janë më të mëdha. E rëndësishme është të jemi me këmbë në tokë dhe të vazhdojmë të qetë rrugëtimin tonë. I përgëzoj të gjithë djemtë për atë ccka kanë treguar në fushën e blertë në këto muaj kampionat. Besoj që në janar do të rikthehemi edhe më të fortë. Duhet ti festojmë festat të kënaqur", perfundoi Nica prononcimin e tij